

ANGAZHIMI PËR VEPRIM TË PËRBASHKËT - EJA KOSOVË

UDHËZUES PËR APLIKIM PËR GRANTE PËR ZHVILLIM ORGANIZATIV

HYRJE

EJA Kosovë (ang. Engagement for Joint Action - Angazhimi për Veprim të Përbashkët) është program i KCSF-së që mbështet nismat e shoqërisë civile përmes granteve dhe ndërtimit të kapaciteteve me synimin e përgjithshëm për t'i kontribuar një shoqërie demokratike e gjithëpërfshirëse në Kosovë në rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian. E themeluar si mekanizëm i financimit ku disa donatorë i bashkojnë fondet e tyre për përkrahjen e shoqërisë civile, EJA Kosovë aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Luksemburgut.

Duke vënë në plan të parë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve përgjatë tërë punës së shoqërisë civile, EJA Kosovë synon të kontribuojë drejt dy qëllimeve kryesore ku: (a) shoqëria civile shfrytëzon hapësirat për avokim dhe synon krijimin e mundësive/hapësirave të reja për pjesëmarrje të qytetarëve dhe qytetareve në formësimin e çështjeve me interes publik, dhe (b) organizatat e shoqërisë civile forcojnë lidhjet me qytetarë dhe përmirësojnë llogaridhënien dhe transparencën ndaj anëtarëve dhe publikut të gjerë.

EJA Kosovë bazohet në premisën që përmes sistemeve të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qasjes dhe komunikimit më të mirë me komunitetin, nga ana tjetër, OSHC-të do ta përbrendësojnë praktikën e përfshirjes së qytetarëve në punën e tyre dhe do të zhvillojnë një bashkëpunim më të thellë duke i kontribuar kështu drejtpërdrejt forcimit të lidhjes me grupet e qytetarëve për të cilët angazhohen. E kombinuar me qeverisje të brendshme më të mirë dhe transparencë e llogaridhënie të shtuar, EJA Kosovë pritet të rrisë besimin në shoqërinë civile si një platformë e përshtatshme për t'i shprehur shqetësimet e qytetarëve.

Kosova vazhdon të përballet me shumë vështirësi socio-ekonomike, me papunësi të lartë, gjendje ekonomike të rënduar, nivele të larta të korrupsionit, ndërsa trendet pozitive të vitit të fundit në raport me punën e institucioneve kryesore publike sfidohen nga një periudhë shumë e gjatë e mosbesimit në këto institucione. Gratë, rinia, pakicat nga komunitetet Rom, Ashkali e Egjiptian si dhe Serb, personat me nevoja të veçanta, komuniteti LGBTI dhe të moshuarit janë më të prekurit nga këto vështirësi. Roli i shoqërisë civile është që t'iu shërbej këtyre grupeve, por poashtu edhe të kërkojë reagim e përgjegjësi institucionale për nevojat e tyre. Ngajshëm, shoqëria civile e ka të domosdoshme për të përforcuar lidhjet me qytetarët, për të ndërtuar besim dhe komunikim me komunitetin dhe për të vepruar si mbikqyrës të institucioneve. Përhapja në nivel global e COVID-19 dhe efektet e kësaj pandemie, përfshirë krizat e rritjes së çmimeve e muajve të fundit që e kanë prekur standardin jetësor të shumicës së popullësisë, kanë ekspozuar edhe më tej pabarazitë në shoqërinë tonë, duke ndikuar në mënyrë disproporcionale në grupet më të marginalizuara. Pabarazitë tashmë ekzistuese në shoqërinë tonë do të bëhen edhe më të thella nëse grupet e marginalizuara nuk sillen në qendër të vëmendjes gjatë fazës së rimëkëmbjes. Është e nevojshme që shoqëria civile të mobilizohet dhe t'iu jap zë atyre që iu duhet më së shumti në këtë kohë.

Bashkëfinancuar nga:

1. HISTORIKU

Qytetarët e Kosovës po ballafaqohen me një pabarazi të thellë dhe shumicës së tyre iu janë tjetërsuar burimet, mundësitë, vendimmarrja dhe jeta politike. Proceset gjithëpërfshirëse dhe institucionet e hapura janë përjashtim, e jo normë.

Politikëbërja do të kuptohet përtej proceseve formale të natyrës normative, pasi ajo i përfshin të gjitha aspektet e shoqërisë dhe të jetës publike. Për t'i adresuar nevojat e të gjithë qytetarëve, politikëbërja duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë, përtej atyre që janë në pushtet ose disa të tjerëve që janë të arsimuar mirë dhe elokuent në shkrimin ligjor dhe të politikave. Çdo kosovar, burrë e grua, djalë e vajzë, duhet ta ketë mundësinë për t'i adresuar nevojat, shqetësimet dhe propozimet e veta në mënyrën më të përshtatshme për kapacitetet, nevojat dhe kontekstin e tij/saj. Shoqëria civile ka një mundësi, por edhe përgjegjësi, për t'i fuqizuar qytetarët dhe për t'i sjellë shqetësimet dhe zërin e tyre në vëmendjen e politikave publike dhe të diskursit publik.

Të vetëdijshëm për diversitetin e shoqërisë civile dhe qasjet e ndryshme, EJA Kosovë përqendrohet në nisma të shoqërisë civile dhe individë që kultivojnë praktika pjesëmarrëse në punën e tyre sepse beson që vetëm duke i përfshirë sistematikisht qytetarët në punën e tyre, shoqëria civile u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Për më tepër, EJA Kosovë beson që një përfshirje e tillë shkon paralelisht me rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së shoqërisë civile, si dhe me përmirësimin e praktikave të qeverisjes së brendshme përtej dokumenteve e raportimeve. Bashkimi i përpjekjeve përmes rrjetëzimit dhe ndërtimit të aleancave do ta maksimizojë potencialin për ndryshim në një kontekst të burimeve të pakta njerëzore e financiare. Duke ua shtuar këtë kapaciteteve dhe përvojës tashmë ekzistuese të shoqërisë civile, EJA Kosovë synon ta ngushtojë boshllëkun ekzistues midis shoqërisë civile dhe qytetarëve dhe të kontribuojë në rritjen e legjitimitetit të shoqërisë civile.

a. Instrumentet e mbështetjes të EJA Kosovë

EJA Kosovë është dizajnuar me qëllimin për ta lehtësuar dhe mbështetur në mënyrë adekuate këtë qasje të re, përmes sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare dhe kapaciteteve të nevojshme për iniciativat e shoqërisë civile dhe individët e interesuar për t'i kontribuar një shoqërie demokratike e gjithëpërfshirëse në Kosovë. Përmes *granteve institucionale*, EJA Kosovë mbështetë organizata të konsoliduara që kanë strategji të qartë për ta vazhduar punën e tyre në fushat përkatëse tematike; përmes *granteve për zhvillim organizativ*, EJA do t'i mbështesë organizatat që kanë drejtim të qartë të zhvillimit, por që kanë nevojë për mjete dhe burime specifike për ta avancuar punën e tyre; përmes *granteve për projekte*, do mbështetë veprime specifike të nismave të shoqërisë civile dhe individëve që adresojnë çështje konkrete, qoftë të një natyre më sistematike ose më të kufizuar në shtrirje dhe kohëzgjatje; përmes *granteve urgjente*, EJA mundëson reagime të menjëhershme të nismave të shoqërisë civile dhe individëve ndaj zhvillimeve të papritura të rëndësisë publike; dhe përmes *Çmimit për Demokraci që ndahet në baza vjetore*, njeh kontributet e jashtëzakonshme për zhvillimin e demokracisë në Kosovë dhe promovon rastet dhe modelet që duhet ndjekur. Trajnimi dhe mentorimi, si dhe mundësitë për rrjetëzim dhe ndërtim të aleancave do të ofrohen si mundësi shtesë përveç mbështetjes financiare.

b. Grantet për zhvillim organizativ (GZHO)

EJA Kosovë beson se OJQ-të kanë potencial për të kontribuar në shumë fusha. Ky potencial zakonisht vërehet në OJQ-të e konsoliduara, që kanë një vizion të qartë dhe punojnë sistematikisht për të zbatuar strategjinë e tyre. Megjithatë, ka edhe OJQ të tjera që nuk janë ende në atë nivel të konsolidimit, por kanë drejtim të qartë të zhvillimit të tyre, përfshirë qëllimet programore dhe grupet e qytetarëve të cilët i përfaqësojnë ose i synojnë me punën e tyre. Sidoqoftë, ky potencial nuk është shfrytëzuar plotësisht pasi struktura e financimit që kanë nuk mbështet zhvillimin organizativ. Ky zhvillim pengohet nëse organizatat zbatojnë vetëm aktivitete të projekteve të shkurta dhe strikte pa ndonjë mundësi për të kontribuar në rritje të organizatës, ndërtim të kapaciteteve dhe avancim të sistemeve të brendshme. Në mënyrë që të kompensojnë këtë mungesë fondesh që nuk e favorizon zhvillimin organizativ, këto OJQ shpesh janë të detyruara të përdorin burime të brendshme edhe ashtu të kufizuara ose fonde në kuadër të ndonjë projekti që nuk janë të parapara drejtpërdrejt për atë qëllim.

Duke marrë mbështetje për zhvillim organizativ të përshtatur për nevojat dhe karakteristikat e veçanta të tyre, organizatat e synuara do të mund të përdorin këto fonde të dedikuara për zhvillimin e organizatës në vend të atyre për zbatimin e projekteve specifike. Në veçanti, këto grante synojnë të mbështesin ndërtimin e kapaciteteve të stafit, zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve dhe procedurave të brendshme, zhvillimin e politikave dhe dokumenteve të brendshme, përdorimin e softuerëve dhe pajisjeve ose metodologjive dhe qasjeve specifike. Ngjashëm me instrumentet tjera të EJA Kosovë, këto grante u mundësojnë organizatave që gjithashtu të adresojnë në mënyrë të vazhdueshme e sistematike përfshirjen e qytetarëve në punën e tyre dhe t'i përmirësojnë praktikën e qeverisjes së brendshme.

2. KËRKESAT E PËRGJITHSHME TË THIRRJES

a. Kriteret e pranueshmërisë

Për të pasur të drejtë për aplikim, aplikanti duhet t'i plotësojë kriteret në vijim:

- Të jetë organizatë joqeveritare vendore e regjistruar në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë (degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë nuk kanë të drejtë të aplikojnë);
- Të jenë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin e grantit;
- Të dëshmojnë aftësi për menaxhimin e grantit të propozuar;
- Të mos jenë të udhëhequra ose të menaxhuara nga Persona të ekspozuar politikisht¹.

¹ Për më shumë rreth kufizimeve në lidhje me personat e ekspozuar politikisht (PEP), shih mostrën e formës së aplikacionit. Të gjitha organizatat aplikuese janë të detyruara të deklarojnë se asnjë person në pozicionet drejtuese, sipas listës dhe përcaktimit të Personave të ekspozuar politikisht, të paraqitura në formularin e aplikacionit, nuk bien nën këtë kategori.

b. Për organizatat joqeveritare

OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se angazhimi i tyre është në fushën e demokratizimit dhe fushave të programit EJA Kosovë. Përkundër statusit të tyre juridik, jo të gjitha OJQ-të janë të përfshira në kriteret e mësipërme të përshtatshmërisë. Për shkak të fushëveprimit të gjerë të legjislacionit në fuqi në Kosovë për regjistrimin e OJQ-ve, klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore ose organizatat fetare, që janë të regjistruara si OJQ, nuk janë synim i granteve të KCSF-së. Ngjashëm, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme për të cilat është e qartë që kanë aftësi financiare për të mbuluar shpenzimet e organizatës së tyre ose për të përkrahur aktivitetet e tyre, nuk janë synim i granteve të KCSF-së.

c. Numri i aplikacioneve

Organizatat mund të paraqesin vetëm një aplikacion.

d. Kohëzgjatja dhe buxheti

Organizatat mund të aplikojnë për financim për më së paku 6 muaj dhe më së shumti deri në 14 muaj.

Buxheti maksimal që mund të kërkohet për grant nga kjo thirrje është 15,000 EUR.


e. Fushat e intervenimit

Përderisa grantet për zhvillim organizativ synojnë posaçërisht aktivitetet që janë të përqendruara në zhvillimin e brendshëm të organizatës, supozimi është që avansimi i sistemeve të punës do të ndikojë në shtimin e kontributit të tyre në fushën që mbulojnë, e që rrjedhimisht duhet të jenë në përputhje me fushat e mëposhtme të ndërhyrjes të EJA Kosovë.

EJA Kosovë synon t'i kontribuojë angazhimit të shtuar qytetar për të ndikuar në prioritetet, planifikim, marrje të vendimeve dhe zbatim të politikave publike në qeverisjen lokale e qendrore, me theks të veçantë në fushat e mëposhtme prioritare:

- Pjesëmarrje më e lartë e grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara në planifikim buxhetor;
- Përmirësimi i të drejtave socio - ekonomike e kulturore të grupeve të marginalizuara;
- Forcimi i rolit të shoqërisë civile në avokim dhe mbikëqyrje, me theks të veçantë në të drejtat dhe nevojat e grupeve të marginalizuara;
- Fuqizimi i të rinjve për të marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e politikave;
- Edukimi qytetar për të drejtat e njeriut.
-

Aktivitetet e mbikëqyrjes, monitorimit të hartimit dhe zbatimit të politikave dhe legjislacionit, kontributi në politika publike, kontributi në tema më sfiduese që nuk trajtohen zakonisht, përmirësimi i përfaqësimit të grupeve të marginalizuara, krijimi dhe shfrytëzimi i hapësirave publike, ngritja e vetëdijes dhe edukimi në luftimin e stereotipeve gjinore, si dhe përfaqësimi i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve do të ishin ilustrime të disa prej nismave që do të mbështeten dhe që i përshtaten teorisë së ndryshimit të këtij programi.



EJA Kosovë do të mbështesë nismat që do të përqendrohen në adresimin e të drejtave dhe nevojave të grupeve të marginalizuara, përkatësisht grave, personave me nevoja të veçanta, romëve, ashkalinjve, egjiptianëve dhe pakicave serbe, komunitetit LGBTI, të moshuarve dhe të rinjve.

f. Niveli i intervenimit dhe mbulimi gjeografik

Përmes kësaj thirrje do t'u ofrohet mbështetje OJQ-ve në mbarë Kosovën të cilat kërkojnë të sjellin ndryshime në nivelin lokal (komunal) dhe/ose kombëtar (qendror). Në veçanti, të paktën 30% e përfituesve të granteve për zhvillim organizativ do të jenë organizata me seli dhe që operojnë jashtë Prishtinës.

g. Përfshirja e qytetarëve

Angazhimi i qytetarëve gjatë gjithë punës së organizatës është një aspekt i rëndësishëm i intervenimeve të mbështetura nën EJA Kosovë. Prandaj, aplikantët pritet të sqarojnë qartë si mendojnë t'i përfshijnë qytetarët në punën e tyre, në kuadër të strategjive të tyre aktuale dhe punën në të ardhmen.

Aplikantët duhet ta paraqesin një analizë të qartë të grupit të tyre të synuar, arsyen pse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre është e rëndësishme për punën e organizatës dhe mënyrat e ndryshme në të cilat synojnë t'i angazhojnë grupet e synuara.

Në analizën e grupit të tyre të synuar, aplikantët pritet të dëshmojnë njohje të dallimeve të atyre grupeve (si gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja, arsimi, vendndodhja, rrethanat socio-ekonomike, interesat dhe nevojat) dhe t'i përshtatin propozimet dhe intervenimet e tyre sipas rrethanave përkatëse. Aplikantët gjithashtu pritet ta analizojnë potencialin për angazhim të grupeve të synuara dhe ta zhvillojnë një qasje realiste për rritje graduale por sistematike, të përfshirjes së atyre grupeve në punën e organizatës.

OJQ-të e përkrahura do të kenë qasje në mentorim dhe ndërtim të kapaciteteve për avokim pjesëmarrës dhe mobilizim të komunitetit, që do të sigurojë ndihmë në zhvillimin e planit për përfshirjen e qytetarëve mbi përvojën e tyre të mëparshme. Për udhëzime lidhur me përfshirjen e qytetarëve, ju lutemi shikoni dokumentin e shkurtër Udhëzues për aplikantët: Përfshirja e qytetarëve në [webfaqen e KCSF-së](#) duke iu referuar programit EJA Kosovë.

h. Qeverisja e brendshme

Qeverisja e brendshme e OJQ-së mbetet një aspekt i rëndësishëm në përpjekjet për ta përmirësuar dhe ndërtuar besimin e qytetarëve në sektorin e shoqërisë civile dhe për të qenë në gjendje që organizatat të shërbejnë si shembull.

Të gjithë aplikantët pritet të japin informacione për mekanizmat e kontrollit të brendshëm, strukturën e menaxhimit, marrjen e vendimeve brenda organizatës dhe menaxhimin financiar. Aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen një vlerësimi të detajuar gjatë vizitave në zyre nga KCSF, me ç'rast duhet të paraqiten dokumentet mbështetëse për të gjitha kategoritë e lartpërmendura.

Pas këtij vlerësimi fillestar, KCSF-ja do të punojë intensivisht me organizatat e mbështetura për ta zhvilluar një mentorim të përshtatur për adresimin e nevojave të identifikuar, të praktikave të

qeverisjes së mirë, të menaxhimit të mirë financiar dhe të parimeve të transparencës, anti-korrupsionit dhe llogaridhënies.

i. Bashkëpunimi/Ndërtimi i aleancave

Për ta nxitur një bashkëpunim më të madh për veprim të përbashkët ndërmjet OJQ-ve, EJA Kosovë do të sigurojë platforma të ndryshme dhe mundësi për takime ku OJQ-të mund të takohen dhe shkëmbejnë përvoja në mes vete. Organizimi dhe veprimi i përbashkët për çështje me interes të përbashkët është rezultat i synuar, prandaj pritet që organizatat e mbështetura të jenë proaktive për t'i identifikuar dhe kontribuar në mundësitë për mobilizimin e nismave të tjera të shoqërisë civile në fushat e tyre të punës.

Ngjarjet tematike janë një platformë e cila do të jetë në dispozicion për të gjitha organizatat e mbështetura për të propozuar çështje përkatëse në fushën e tyre të punës dhe/ose çështje që nuk bien drejtpërdrejt në fushën e tyre të punës, por që konsiderohen të rëndësishme, urgjente dhe relevante. Meqenëse qëllimi i EJA Kosovë është të zgjerojë veprimtarinë e shoqërisë civile në të gjithë vendin dhe të kontribuojë në krijimin e lidhjes me qytetarët, synohet që këto ngjarje tematike të organizohen kryesisht jashtë Prishtinës.

j. Temat horizontale

Integrimi gjinor si mjet drejt barazisë gjinore do të jetë një çështje horizontale në të gjitha intervenimet. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha organizatat e mbështetura pritet t'i shtrijnë intervenimet e tyre në mënyrë të barabartë mes gjinive, të jenë të kujdesshme për efektet e intervenimit për burra e gra, djem e vajza, dhe të mos kontribuojnë në stereotipe të dëmshme. Të gjitha organizatat e mbështetura pritet t'i mbledhin dhe t'i ruajnë të dhënat të ndara sipas gjinisë. Për udhëzime lidhur me integrimin gjinor, ju lutemi shikoni dokumentin e shkurtër Udhëzues për aplikantët: Integrimi gjinor në webfaqen e KCSF-së duke iu referuar programit EJA Kosovë.

3. PRANUESHMËRIA E AKTIVITETEVE DHE SHPENZIMEVE

Buxheti i propozuar do të përdoret ekskluzivisht për zhvillim organizativ, dhe i cili përfshin por nuk kufizohet në ndërtimin e kapaciteteve, avancimin e sistemeve të brendshme, zhvillimin e politikave dhe dokumenteve të brendshme, softuerëve dhe pajisjeve ose metodologjive dhe qasjeve specifike të punës. Nga ky grant nuk do të mbulohen pagat, përveç në rastet kur një përqindje e caktuar e kohës së një anëtari të stafit i dedikohet specifikisht menaxhimit të aktiviteteve të zhvillimit organizativ. Nga ky grant nuk do të mbulohen shpenzimet administrative, përveç shpenzimeve që janë dedikuar posaçërisht për aktivitetet e grantit për zhvillim organizativ dhe/ose personelit të angazhuar specifikisht në menaxhimin e aktiviteteve të zhvillimit organizativ. Në rastet kur aplikohet me buxhet që i përfshinë këto dy kategori buxhetore (1) Burimet njerëzore dhe (2) Shpenzimet administrative, buxheti i kërkuar për këto kategori së bashku nuk duhet të kalojë 20% të shumës totale të grantit.

a. Aktivitetet e papranueshme

Aktivitetet në vijim nuk do të mbështeten:

- Të gjitha aktivitetet të cilat nuk kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin organizativ;

- Aktivitete në të cilat organizata përfituese shërben vetëm si ndërmjetës për palët e treta;
- Aktivitete të zhvillimit organizativ por që kanë shumë nivele të aprovimit nga palë të treta e që rrjedhimisht përmbajnë në vete rrezik të lartë gjatë zbatimit dhe arritjen e rezultateve;
- Aktivitetet që drejtpërdrejt lidhen me partitë politike ose që i mbështesin ato;
- Investimet kapitale;
- Bursat.

Në parim, aktivitetet e listuara më poshtë nuk inkurajohen:

- Përveç në rastet kur aktivitetet synojnë pjesëmarrës nga grupet e qytetarëve me të cilat punon organizata, në këtë listë hyjnë edhe aktivitetet në vende (siç janë hotelet) që nuk janë të hapura dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët e rëndomtë, përveç nëse janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve të synuara të grantit;
- Pjesëmarrja në aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve që mbahen jashtë Kosovës, me përjashtim të rasteve kur një aktivitet/trajnim i tillë është thelbësor për zhvillimin e organizatës dhe nuk mund të bëhet në Kosovë, si dhe justifikohet qartësisht me shkrim nevoja;
- Udhëtimet studimore jashtë Kosovës, me përjashtim të rasteve kur një aktivitet i tillë është thelbësor për zhvillimin e organizatës dhe një informacion apo njohuri e tillë nuk mund të merret pa një vizitë të drejtpërdrejtë jashtë vendit, si dhe justifikohet qartësisht me shkrim nevoja.

b. Shpenzimet e pranueshme

Për t'u konsideruar të pranueshme, shpenzimet duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

- Janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm dhe arritjen e zhvillimit organizativ;
- Janë të arsyeshme, të justifikuara dhe përputhen me kërkesat e menaxhimit të mirë financiar, përfshirë llogaritjet e drejta dhe të bazuara në çmime të tregut dhe efikasitetin e shpenzimeve;
- Përputhen me kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë;
- Do të ndodhin gjatë zbatimit të grantit;
- Janë të paraqitura në buxhetin e propozuar;
- Janë të identifikueshme dhe të verifikueshme;

c. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e paraqitura më poshtë konsiderohen të papranueshme:

- Pagat e stafit, përveç në rastet kur një përqindje e caktuar e kohës së një anëtari të stafit i dedikohet specifikisht menaxhimit të aktiviteteve të zhvillimit organizativ²;
- Shpenzimet administrative, përveç shpenzimeve që janë dedikuar posaçërisht për aktivitetet e grantit për zhvillim organizativ dhe/ose personelit të angazhuar specifikisht në menaxhimin e aktiviteteve të zhvillimit organizativ;
- Renovime/ndërrhyrje në objekt/zyre;
- Blerja e pajisjeve të cilat nuk janë të domosdoshme për zhvillimin organizativ të synuar;
- Taksat doganore dhe të importit;

² Nëse aplikohet, shuma totale e buxhetit për këto dy kategori së bashku 1) Burimet njerëzore dhe 3) Shpenzimet administrative dhe të zyrës nuk duhet të kalojnë 20% të shumës totale të grantit.

- Borxhi ose pagesat për humbje;
- Tatimi mbi vlerën e shtuar - TVSH (për faturat mbi 200 EUR);
- Pagesat e huasë dhe të interesit;
- Tarifat e këmbimit të valutave;
- Shpenzimet e amortizimit të pajisjeve;
- Blerja e tokës ose pronës së paluajtshme;
- Blerja e automjetit ose gjeneratorit;
- Pagesat e shpenzimeve që mbulohen nga donatorë të tjerë;
- Kredi për palët e treta.

4. PROCEDURA E APLIKIMIT

a. Dokumentet e detyrueshme

Përveç formularit të aplikimit, aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së, e lëshuar nga Departamenti për OJQ;
2. Certifikata e Numrit Fiskal (në rastet kur ky numër nuk është në certifikatën e regjistrimit);
3. Statuti i Organizatës (versioni i nënshkruar dhe identik me Statutin cili i është dorëzuar Departamentit për OJQ);
4. Nëse aplikanti është fondacion ose institut, lista e anëtarëve të Bordit Drejtues;
5. Nëse aplikanti është shoqatë, emri i Kryesuesit/es të Kuvendit të Anëtarëve. Poashtu, nëse shoqata ka bord/e apo ndonjë organ tjetër të ndërmjetëm, lista e anëtarëve të atij organi;
6. Deklarata mbi Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP) (sipas formës së EJA Kosovë);
7. Biografia e shkurtër e personit përgjegjës për këtë grant;
8. Buxheti i propozuar (sipas formularit të EJA-s për GZHO);
9. Pasqyrat vjetore financiare të organizatës³ për dy (2) vitet e fundit (2021 dhe 2020);
10. Raportet e auditorit⁴ për 2020 dhe 2019⁵, në rast që organizata aplikuese është e obliguar që të ketë raport të auditorit ose në rast që e posedon një të tillë pavarësisht obligimit.

Të gjitha dokumentet për aplikim mund të shkarkohen nga webfaqja www.kcsfoundation.org.


b. Dorëzimi i aplikacioneve

Aplikacionet e kompletuara mund të dorëzohen vetëm përmes emailit në adresën aja@kcsfoundation.org.

³ Pasqyrat vjetore financiare duhet minimalisht të përmbajnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve. Për organizatat e krijuara së fundmi, vetëm nëse është e aplikueshme.

⁴ Raportet e auditorit duhet t'i përfshijnë të gjitha pasqyrat kryesore financiare të organizatës. Për organizatat e themeluara së fundi, vetëm nëse është e aplikueshme.

⁵ Organizatat që e kanë përfunduar auditimin vjetor për vitin 2021 mund t'i dërgojnë raportet e auditorit për vitet 2020 dhe 2021.



E-maili duhet ta përmbajë formularin e kompletuar të aplikimit dhe të gjitha dokumentet e obligueshme të theksuara në thirrjen për aplikim. Aplikantëve do t'u kërkohej të verifikojnë nëse aplikacioni i tyre është i plotë duke përdorur listën e kontrollit të paraqitur në formularin e aplikimit. KCSF-ja do ta konfirmojë pranimin e aplikacionit duke iu përgjigjur aplikantit me një email konfirmimi.

Aplikacionet që nuk janë në pajtim me rregullat e këtyre udhëzimeve nuk do të shqyrtohen.

c. Afati i fundit për paraqitjen e aplikacionit

Afati i fundit për aplikim është **24.03.2022** deri në orën **23:59**.

d. Kontakti:

Për pyetjet lidhur me përgatitjen e dokumenteve për aplikim mund të na kontaktoni në ejainfo@kcsfoundation.org, jo më vonë se 15/03/2022. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet do të publikohen në seksionin Q&A (pyetje dhe përgjigje) të webfaqes së KCSF-së, jo më vonë se 18/03/2022.

Aplikantët këshillohen ta kontrollojnë seksionin Q&A, të publikuar në webfaqe.

Luteni ta përdorni vetëm emailin e specifikuar për komunikim me KCSF-në në lidhje me procesin e aplikimit.

5. VLERËSIMI DHE NJOFTIMI

Vlerësimi i aplikacioneve do të bëhet në dy faza:

- 1) Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale) dhe
- 2) Vlerësimi i përmbajtjes (bazuar në kategoritë dhe kriteret e vlerësimit).

a. K Kontrolli administrativ (verifikimi i kriterëve formale)

Të gjitha aplikacionet vlerësohen gjatë kësaj faze për të parë nëse kriteret në vijim janë respektuar/dorëzuar:

1. Afati për dorëzimin e aplikimit;
2. Të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të paraqitura në formularin e aplikimit;
3. Dokumentet e detyrueshme, përfshirë edhe pranueshmërinë e organizatave;
4. Shumën e kërkuar; dhe
5. Kohëzgjatjen e grantit.


Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret e specifikuar do të refuzohen automatikisht.

Rezultatet e përputhshmërisë me kriteret administrative i komunikohen secilit aplikant me shkrim.

b. Vlerësimi i aplikacioneve dhe vendimi përfundimtar

Aplikacionet që e kalojnë pajtueshmërinë administrative do të vlerësohen nga ekipi për vlerësimin e granteve (EVG), i përbërë nga pesë ekspertë të jashtëm me ekspertizë dhe njohuri përkatëse. EVG do t'i vlerësojë aplikacionet në dy faza, përmes: 1) shqyrtimit të dokumenteve dhe 2) intervistave publike

Anëtarët e EVG-së do t'i vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve dhe peshës si vijon:

- 
1. Cilësia dhe rëndësia e qëllimeve dhe drejtimit programor të organizatës (25%);
 2. Cilësia dhe relevanca e aktiviteteve të zhvillimit organizativ në lidhje me qëllimet programore (30%);
 3. Përfshirja e qytetarëve/grupeve të synuara në punën e organizatës (20%);
 4. Niveli i kapacitetit organizativ dhe qeverisjes së brendshme (15%);
 5. Efikasiteti i shpenzimeve të buxhetit të propozuar (10%);

Vlerësimi maksimal për aplikacion është 100 pikë.

Pas vlerësimit fillestar të aplikacionit të dorëzuar dhe të gjitha dokumenteve të detyrueshme, aplikantët që marrin së paku **51 pikë** (nga gjithsej 100), si dhe gjysmën e pikëve në dispozicion (50%) në secilën nga të pesë kategoritë e paraqitura më lart, do të përzgjidhen në listën e ngushtë.

KCSF-ja do të organizojë vizita në të gjitha organizatat e përzgjedhura në listën e ngushtë përveç atyre organizatave të cilat e kanë pasur një vizitë të ngjashme nga KCSF gjatë dy viteve të fundit, e të cilave do t'u kërkohej një konfirmim me shkrim që nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm të gjetjeve nga vizita e kaluar. Vizita e stafit të KCSF-së do të përqendrohet në kapacitetin organizativ, qeverisjen e brendshme dhe menaxhimin financiar. Pas vizitës, një raport përgatitet dhe dërgohet te Ekipi për vlerësimin e granteve për secilën organizatë. Të gjitha këto organizata do të ftohen në intervista publike. Intervista e aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë përbëhet nga një prezantim i shkurtër i propozimit të grantit (5 min) dhe një seancë Pyetje dhe Përgjigje (10 min) me anëtarët e ekipit për vlerësimin e granteve.

Pas përfundimit të intervistave, Ekipi për vlerësimin e granteve rekomandon listën e aplikantëve për ndarjen e grantit për zhvillim organizativ. Për t'u konsideruar për financim, aplikantët duhet t'i marrin së paku **71 pikë** në total, si dhe gjysmën e pikëve në dispozicion (50%) në secilën nga të pesë kategoritë e paraqitura më lart.

Lista e aplikantëve të rekomanduar për një grant do të rishikohet bazuar në fondet në dispozicion dhe kuotën gjeografike, ku të paktën 30% e përfituesve do të jenë organizata me seli dhe që veprojnë jashtë Prishtinës.

Aplikacionet me rezultatin më të mirë përfundimtar brenda buxhetit total të paraparë për këtë thirrje rekomandohen për financim.

Buxheti i paraparë për këtë thirrje është 90,000.00 EUR. Megjithatë, në varësi të përmbushjes së kriterëve dhe cilësisë së aplikacioneve, KCSF rezervon të drejtën që të mos shpërndajë të gjitha fondet në dispozicion. Donatorët e kanë të drejtën e vetos për aplikacionet e financuara që konsiderohen se bien ndesh me vlerat e promovuara nga donatori ose përkojnë me intervenimet të tjera të ngjashme.

Para nënshkrimit të kontratës, aplikantët e suksesshëm do të përkrahen nga KCSF-ja për ta finalizuar dosjen e tyre. Gjatë kësaj faze të gjitha kushtet e vendosura nga EVG duhet të plotësohen. KCSF gjithashtu rezervon të drejtën të komentojë dhe të propozojë ndryshime të vogla të cilat nuk e ndryshojnë aplikacionin apo aktivitetet e aprovuara por kontribuojnë në zbatimin më të suksesshëm të grantit.

c. Njoftimi për vendimin dhe shqyrtimi i ankesave

Secili aplikant që ka marrë pjesë në procesin e aplikimit do të pranojë përgjigje lidhur me procesin vlerësues dhe rezultatin e aplikacionit të tyre, përfshi rezultatin e përgjithshëm. Aplikantët e pasuksesshëm mund të kërkojnë sqarime. Në rast se ata konsiderojnë se propozimi i tyre nuk është vlerësuar bazuar në meritat edhe pas marrjes së sqarimeve shtesë, aplikantët mund të paraqesin një ankesë zyrtare. Procedura për të kërkuar sqarime shtesë ose ankesë është publike në [webfaqen e KCSF-së](#). Informacioni mbi përfituesit e përzgjedhur të granteve do të publikohet në [webfaqen e KCSF-së](#) pasi të jenë nënshkruar kontratat.

6. DATAT E RËNDËSISHME

Procesi	Data tentative
Publikimi i thirrjes për grante për zhvillim organizativ:	23.02.2022
Sesioni informues:	*Detajet do të publikohen në www.kcsfoundation.org
Afati për kërkimin e sqarimeve/pyetjeve:	15.03.2022
Data në të cilën do të publikohen përgjigjet:	18.03.2022
Afati për dorëzimin e aplikacioneve:	24.03.2022
Informata rreth kontrollit administrativ:	Mars 2022
Informata për aplikantët në listën e ngushtë:	Prill 2022
Vizitat e KCSF-së tek aplikantët në listën e ngushtë:	Prill/maj 2022
Intervistat publike me aplikantët në listën e ngushtë:	Maj 2022
Vendimi përfundimtar:	Maj 2022
Nënshkrimi i kontratës:	Qershor 2022
Fillimi i zbatimit të grantit:	Qershor 2022